# DËSHMI ARKIVI

**A-455458**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Shqipëri–Slloveni, rritet bashkëpunimi ekonomik - Turizmi malor dhe përpunimi i drurit në fokus të diskutimeve për investime dhe partneritete të reja |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sociale/shqiperislloveni-rritet-bashkepunimi-ekonomik-turizmi-malor-dhe-perpunim-i586899` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 14:14:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 14:10:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `581cea669c4b459d6b9808eabff90d771a20174a32c52c82d044cfd1332ea1d6` |
| TEKSTI | `84ff8157080c4d4d6f3e776443bbba0b7c73ca54788c47e7331b77c7ff3430b5` |
| PAMJA | `71f1aee35ecf8b6926c8edf634e32d95a51d2734e3d5a4c221ed3c6e4e60f57f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `55a9c6ce727b1fb2e040b6e93a27f5996a9d8247e954563e9b1fff977e3d4e1c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/55a9c6ce727b1fb2e040b6e93a27f5996a9d8247e954563e9b1fff977e3d4e1c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Shqipëri–Slloveni, rritet bashkëpunimi ekonomik - Turizmi malor dhe përpunimi i drurit në fokus të diskutimeve për investime dhe partneritete të reja

TemA

18 Shtator 2026, 16:10Sociale TEMA




Mundësi të reja për bashkëpunim ekonomik mes Shqipërisë dhe Sllovenisë u diskutuan në forumin e biznesit "Slovenia–Albania: An Economic Bridge", zhvilluar në kuadër të MOS Fair 2026 në Celje.

Në aktivitet mori pjesë drejtoresha ekzekutive e AIDA-s, Laura Saro, e cila diskutoi mbi potencialin për zgjerimin e partneriteteve dhe nxitjen e investimeve mes dy vendeve.

Gjatë vizitës, Saro zhvilloi edhe një takim me Leon Korošec, sekretar shteti në Ministrinë sllovene të Ekonomisë, Punës dhe Sportit. Në fokus ishin sektorët me potencial për investime në Shqipëri, veçanërisht turizmi malor, ndërsa u theksua nevoja për forcimin e bashkëpunimit mes AIDA-s dhe SPIRIT Slovenia.

Pala sllovene shprehu gatishmërinë për të marrë pjesë në forume dhe aktivitete të rëndësishme ekonomike që do të zhvillohen në Tiranë.

Një tjetër sektor i diskutuar ishte industria e përpunimit të drurit, me theks te shkëmbimi i njohurive, inovacioni, produktet me vlerë të shtuar dhe mundësitë që ofron tregu shqiptar.

Forumi u organizua nga SPIRIT Slovenia dhe Instituti për Zgjidhje Strategjike (ISR), duke synuar krijimin e lidhjeve të reja mes komuniteteve të biznesit të Shqipërisë dhe Sllovenisë.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Kontroll agjencive funerale në Tiranë, masa për reklamat dhe ekspozimin në zonat e banuara]

15:50 Sociale

[Ilirjan Celibashi kërcënon me mesazhe gazetaren Desada Metaj, reagon AGSH]

15:06 Sociale

[Deputeti i PS, humb bashkëshorten: Mesazhi prekës i tij...]

14:19 Sociale

[FOTO/ Rama vizitë në Malin Athos, kalon natën në një nga manastiret më të njohura ortodokse]

20:57 Sociale / 32 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.